

Programi i Mundësive Profesionale dhe Rrugëve të Karrierës është një program katër vjeçar i krijuar për t'u mësuar nxënësve akademikë funksionalë, jetë të pavarur dhe aftësi profesionale. Përqendrimet profesionale dhe fushat e studimit janë të bazuara në aftësi dhe nxënësit përputhen individualisht me fushat e studimit bazuar në zhvillimin e aftësive, interesit, pikave të forta dhe nevojave të të mësuarit.

Nxënësit e pranuar në programin VOC-P hyjnë në Shkollën e Mesme Teknike Worcester nën Ligjin e Përgjithshëm të Massachusetts, Edhëzimet e Kapitullit 70. Mësimi është përmes një modeli paralel mbështetës, i cili siguron mbështetjen dhe ndihmën e një arsimtari special dhe / ose asistentit të arsimit special, në bashkëpunim me fakultetin dhe stafin e Shkollës së Mesme Teknike Worcester dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Nxënësit e kualifikuar të interesuar për të aplikuar për pranim në programin VOC-P duhet të kontaktojnë Kryetarin e Ekipit të Vlerësimit në shkollat e tyre të mesme të distriktit për të filluar procesin e aplikimit. Aplikimet duhet të plotësohen deri në Mars



### **Deklarata e Misionit:**

Misioni i Programit VOC-P është të identifikojë nxënësit që do të prosperojnë në një eksperiencë profesionale të shkollës së mesme që u lejon atyre mundësi praktike në një mjedis pune. Nxënësit do të vazhdojnë të kenë rritje akademike në nivelin e tyre të pavarur ndërsa demonstrojnë progres në plotësimin e një portofoli MCAS-ALT.

## *Programi I Mundësive Profesionale dhe Rrugëve të Karrierës*

*Vocational Opportunities and Career  
Pathways Program*



## VOC-P Popullata e Targetuar

### Programi i Mundësive Profesionale dhe Rrugëve të Karrierës (VOC-P) në Shkollën e Mesme Teknike Worcester është krijuar për nxënës me nevoja të veçanta të cilët :

- Janë gjetur të përshtatshëm për shërbime të edukimit special për shkak të një paaftësie intelektuale dhe / ose Spektrit të Autizmit si paaftësia e tyre kryesore
- Eshtë përcaktuar nga një Ekip që kanë nevojë për një program thelbësisht të veçantë dhe IEP e të cilëve mund të implementohet në Programin VOC-P.
- Marrin pjesë në Vlerësimin Alternativ të MCAS
- Mund të përfitojnë nga një program që lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e nxënësve për mundësi karriere
- Mund që të sigurtë dhe me zvogëlim të ndihmës, të përdorin një program të përshtatshëm të mbështetur në karrierë që ofrohet në Shkollën e Mesme Teknike Worcester
- Kanë nevojë për një objektiv karriere që mund të përmbushet përmes Programit të Mundësive Profesionale dhe Rrugëve të Karrierës
- Nxënësit do të ndjekin rregullat dhe procedurat e përshkruara në Manualin e Nxënësve të Shkollave Publike Worcester si dhe manualin shtesë të ofruar nga Shkolla e Mesme Teknike Worcester

## Aftësitë e Targetuara Profesionale dhe Fushat e Studimit

**Vetë-Advokimi** - si të komunikoni gjatë punës ose jashtë në komunitet kur lindin probleme dhe të punoni në gjetjen e zgjidhjeve për këto probleme, duke naviguar në internet dhe median sociale në mënyrë që të kërkonit mundësi punësimi

**Aftësitë Profesionale**- trajnim në punë, gatishmëria për punë, intervista, krijimi i rezumesë dhe aftësitë e punës, siguria gjatë punës

**Mundësitë në Komunitet**- nxënësit do të marrin pjesë në praktika vullnetare brenda komunitetit që mund të çojnë në punësim.

**Aftësitë e Punësimit** - mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve, puna në ekip, aftësitë e komunikimit, motivimi, menaxhimi i kohës

**Aktivitetet e jetesës së përditshme** - mbajtja e një ambienti të sigurt, gatimi, pastrimi, veshja, higjiena personale

**Trajnim Udhëtimi**- leximi i një orari të autobusëve për komunitetin, programimi i një udhëtimi me transport të tillë si WRTA, Uber, Lift, etj.

**Buxheti/Manaxhimi i Parasë** - identifikimi dhe numërimin e kartmonedhave dhe monedhave, krahasimi i çmimeve brenda dyqaneve, kthimi i kusurit, përdorimi i një ATM / karte debiti, blerje për të promovuar pavarësinë

## Pamje e Përgjithshme e Programit VOC-P

Nxënësit do të kenë akses në fushat e synuara profesionale që ofrojnë mundësi optimale për të fituar aftësi që do t'i ndihmojnë ata në sigurimin e ndonjë lloji punësimi.

Nxënësit në Programin 9/10 VOC-P fokusohen në aftësitë akademike funksionale, të drejtuara posaçërisht drejt Kornizave të Kurrikulës së MA dhe plotësimit të Portofoleve të MCAS-Alt. Nxënësit që marrin pjesë në Programin VOC-P nuk marrin një diplomë të shkollës së mesme ose certifikatë profesionale. Nxënësit do të marrin një certifikatë të arritjeve pas përfundimit të 4 viteve.

Nxënësit përforcojnë menaxhimin e parave të tyre, aftësitë e të kuptuarit të leximit dhe shkrimit, si dhe aftësitë e buta të nevojshme për sukses gjatë punës. Nxënësit do të eksplorojnë fushat profesionale që korrespondojnë me zhvillimin e aftësive, interesave, pikave të forta dhe nevojave të tyre për të mësuar.

Nxënësit në Programin 11/12 VOC-P vazhdojnë të zhvillojnë dhe përsosin aftësitë në lidhje me menaxhimin e parave dhe buxhetimin, jetesën e pavarur, punësimin dhe fushat profesionale. Nxënësit punojnë në krijimin e një rezymeje ndërsa mësojnë procesin e kërkimit dhe aplikimit për punë dhe mundësi vullnetare. Nxënësit do të kenë përvoja unike dhe do të marrin pjesë brenda komunitetit duke kontribuar në bashkëpunim ndërsa fitojnë eksperiencën tepër të vlefshme.